



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 04 Nr. 1224
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 15/01
Br. str. KAMENICË/A Datum: 2019

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 8 të Ligjit paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës Nr.90/2010), Nenit 5 pikës c, të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe njoftimit nga MASHT Nr.4567, dt: 31.10.2018, Drejtoria Komunale e Arsimit, shpall:

KONKURS

Një (1) Asistent për fëmijët me nevojat e veçanta arsimore (Drejtoria Komunale për Arsimit)

Detyrat dhe përgjegjësitë sipas pikës një (I):

- Ndihmon fëmijët nxënës në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënës në klasë;
- Punon me mësuesin dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgaditë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat identifikuar të fëmijëve, përgaditë informata kthyes për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikqyrë dhe ndihmon fëmijët/ nxënës gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike / personale, mjekësore dhe asiston veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve me mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë –shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin / kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mra ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve,
- Informacionin në shkollë i trajton si plotësisht konfidencial.
- Sipas pikës një (I) duhet të plotësohen kushtet si vijon:

Kandidatët-et të cilët konkurojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Përgatitja profesionale:Shkolla e Mesme dhe Niveli 5-të (postsekondar) i kualifikimit Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore
- Përvojë pune profesionale (E dëshirueshme);
- Aftësi për të punuar me vetëiniciativë në kuadër të planeve të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informatat dhe udhëzimet e dhëna te të tjerët;
- Shkathëtësi kompjuterike në aplikacionet e programeve (Word,Excel,PoWer Point).
- Paga mujore për këtë vend pune do të jetë 379.00€
- Të interesuarit aplikacionit duhet t'ia bashkangjesin këto dokumente:
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional-diplomën universitare
- Dëshminë për përvojën e punës
- Kopje e letërnjoftimit

Formulari-aplikacioni për konkurim duhet të merret dhe dorëzohet në zyrën e pranimin të Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

U.D. Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit

